



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve **Leonard Duka, Erlis Duka, Fatmir Hyseni (alias Musai), Aleksandër Maxhaku, Oltian Loga dhe Dritan Agaj**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimin të zakonshëm. Në përfundim të gjykimin, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Rudina Palloj, Elsa Ulliri dhe Gerd Hoxha, me vendimin nr. 5, datë **21.01.2026** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonard Duka**, për kryerjen e veprës penale “**Vrasja me paramendim**”, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës *S.M (ngjarja e datës 27.08.2019)*, parashikuar nga nenet 78, pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me **28 (njëzet e tetë) vite burgim**.
2. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Leonard Duka**, për kryerjen e veprës penale “**Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit**”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet*.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonard Duka**, për kryerjen e veprës penale “**Grupi i strukturuar kriminal**”, parashikuar nga neni 333/a pg 1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **5 (pesë) vite burgim**.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonard Duka**, për kryerjen e veprës penale “**Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit**”, parashikuar nga neni 278 paragrafi 3 të Kodit Penal, (municionit) *(ngjarja e datës 08.04.2019)*, parashikuar nga neni 278 pg 3 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **4 (katër) muaj burgim**.
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonard Duka**, për kryerjen e veprës penale “**Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit**” *(armët e zjarrit) (ngjarja e datës 08.04.2019)*, parashikuar nga neni 278 pg 4 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.

6. Pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit Leonard Duka, akuzuar për kryerjen e veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikeve (ngjarja e datës 08.04.2019),** parashikuar nga neni 283 pg 1 i Kodit Penal, në referim të nenit 387, pika 1 dhe 328 pika 1, të K.Pr.Penale, *pasi fakti nuk përbën veprën penale.*
7. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Leonard Duka** dënohet me një dënim të vetëm prej **30 (tridhjetë)** vite burgim.
8. Llogaritja e dënimit fillon nga dita e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Leonard Duka** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 **“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.**
9. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Erlis Duka**, për kryerjen e veprës penale **“Vrasja me paramendim”**, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës S.M,(ngjarja e datës 27.08.2019) parashikuar nga nenet 78 pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.*
10. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Erlis Duka**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”**, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.*
11. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Erlis Duka**, për kryerjen e veprës penale **“Grupi i strukturuar kriminal”**, parashikuar nga neni 333/a pg 1 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.*
12. Bazuar në nenet 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, heqjen e masës së sigurimit personal **“Arrest në burg”**, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Erlis Duka** me vendimin nr. 145 datë 10.10.2019 të ish/Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
13. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Hyseni (alias Musai)**, për kryerjen e veprës penale **“Vrasja me paramendim”**, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës S.M,(ngjarja e datës 27.08.2019) parashikuar nga nenet 78 pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
14. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Fatmir Hyseni (alias Musai)**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”**, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.*
15. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Hyseni (alias Musai)**, për kryerjen e veprës penale **“Grupi i strukturuar kriminal”**, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **3 (tre)** vite burgim.
16. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Fatmir**

Hyseni (alias Musai) dënohet me një dënim të vetëm prej **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.

17. Llogaritja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Fatmir Hyseni (alias Musai)** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”.
18. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aleksandër Maxhaku**, për kryerjen e veprës penale “*Vrasja me paramendim*”, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës *S.M.(ngjarja e datës 27.08.2019)* parashikuar nga nenet 78 pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
19. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Aleksandër Maxhaku**, për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet*.
20. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aleksandër Maxhaku**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **3 (tre)** vite burgim.
21. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Aleksandër Maxhaku** dënohet me një dënim të vetëm prej **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
22. Llogaritja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Aleksandër Maxhaku** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”.
23. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale “*Vrasja me paramendim*”, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës *S.M.(ngjarja e datës 27.08.2019)* parashikuar nga nenet 78 pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
24. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, *pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet*.
25. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **3 (tre)** vite burgim.
26. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i*

municionit, parashikuar nga neni 278 paragrafi 3 të Kodit Penal, (municionit) (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 278 pg 3 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

27. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i ameve, armeve shpërthyesë dhe i municionit”**(armët e zjarrit) (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 278 pg 4 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
28. Pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit **Oltian Loga**, akuzuar për kryerjen e veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikeve** (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 283 pg 1 i Kodit Penal, në referim të nenit 387, pika 1 dhe 328 pika 1, të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën veprën penale.
29. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Oltian Loga**, për kryerjen e veprës penale **“Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”**, parashikuar nga neni 323 pg 1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **6 (gjashtë)** muaj burgim.
30. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Oltian Loga** dënohet me një dënim të vetëm prej **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
31. Llogaritja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Oltian Loga** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 **“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”**.
32. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dritan Agaj**, për kryerjen e veprës penale **“Vrasja me paramendim”**, e kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës S.M.(ngjarja e datës 27.08.2019) parashikuar nga nenet 78 pg 2 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **25 (njëzet e pesë)** vite burgim.
33. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Dritan Agaj**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”**, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278, pg 1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
34. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dritan Agaj**, për kryerjen e veprës penale **“Grupi i strukturuar kriminal”**, parashikuar nga neni 333/a pg 2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **3 (tre)** vite burgim.
35. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Dritan Agaj**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit**, parashikuar nga neni 278 paragrafi 3 të Kodit Penal, (municionit) (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 278 pg 3 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
36. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Dritan Agaj**, për kryerjen e veprës penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i**

municionit”(armët e zjarrit) (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 278 pg 4 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

37. Pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit **Dritan Agaj**, akuzuar për kryerjen e veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikeve** (ngjarja e datës 08.04.2019), parashikuar nga neni 283 pg 1 i Kodit Penal, në referim të nenit 387, pika 1 dhe 328 pika 1, të K.Pr.Penale, **pasi fakti nuk përbën vepër penale.**
38. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Dritan Agaj** dënohet me një dënim të vetëm prej **25 (njëzet e pesë) vite burgim.**
39. Llogaritja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Dritan Agaj** do të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, në referim të parashikimeve të nenit 16, pika 1, shkronja a) të ligjit nr. 81/2020 **“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.**
40. Në bazë të nenit 190, pika 1 të K.Pr.Penale e sekuestruara, disponohen si më poshtë:
- Automjeti tip “Skoda Roomster” me targa **** - **të konfiskohet duke kaluar në favor të shtetit;**
 - Automjeti Volkswagen Golf 5 me targë **** - **të konfiskohet duke kaluar në favor të shtetit;**
 - Aparat celular i shtetasit R.M, i markës Huawei seria P30, me nr.IMEI: **** dhe IMEI 2: ****, me kartë SIM me nr.telefoni ****, nr. telefoni **** – **t’i kthehet personit që i përket.**
 - Portofol Luis Vuiton ngjyrë e zezë (gjetur në automjetin Audi8) i cili në brendësi të tij ka katër kartëmonedha 50 euro, 1 kartëmonedhë 20 euro, 1 kartëmonedhë 10 euro, një kartë Credins Bank, dhe një copë letër e verdhë – **t’i kthehet personit që i përket.**
 - Automjeti mercedez benz CLS me targa **** – **të qëndrojë në ruajtje në funksion të proçedimit të ndarë.**
 - Dy telefonat e viktimës S.M: Celular i markës IPHONE X me nr. IMEI **** me kartë SIM me nr. **** dhe Blackberry me kartë Sim Telekom me nr. **** – **të qëndrojë në ruajtje në funksion të proçedimit të ndarë.**
 - Dy aparate celulare të të pandehurit Leonard Duka: Një aparat celular i markës Samsung me nr. IMEI: **** dhe IMEI 2: **** dhe një aparat celular me mbishkrimin **** me nr. të stampuar në pjesën e pasme të tij **** me nr. IMEI: **** dhe IMEI 2: **** – **të qëndrojë në ruajtje në funksion të proçedimit të ndarë.**
 - Aparat celular i markës Samsung i të pandehurit Dritan Agaj me nr. IMEI : **** dhe IMEI2: **** – **të qëndrojë në ruajtje në funksion të proçedimit të ndarë.**
 - Aparate celulare të markës: Samsung model SM-G965F me nr.IMEI **** dhe IMEI2: ****; Samsung model SMJ320FN me nr.IMEI: ****; IPHONE model A1586 me nr. IMEI: **** ku brenda tij ka kartën SIM me nr.serial **** – **të qëndrojë në ruajtje në funksion të proçedimit të ndarë.**
 - Një USB me mbishkrimin ****, sekuestruar në automjetin Skoda me targë ****; Një fletore me vija të gjera ku në kapakun e saj ka mbishkrimin “*****” në faqen e parë fillon me muajin Qershor, e shkruar me shkrim dore dhe vijon me targën e automjetit **** etj; Një DVR me nr.serial ****, IP adrese **** (e

sende te tjera të lëna në ruajtje në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë) – ***të qëndrojnë në ruajtje në funksion të procedimit të ndarë.***

41. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore (*sipas formularit përkatës bashkëlidhur*) i ngarkohen të pandehurve të deklaruar fajtorë, në mënyrë solidare.
42. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 21.01.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar